



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:018755  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05718313

P.nr.2024:018755

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretarja juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.D, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.14/24 të dt.17.01.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.10.05.2024, ku prezent ishin Prokurorja e shtetit Uridia Caka, i akuzuari F.D si dhe i dëmtuari F.Sh, me dt.13.05.2024, shpallë, ndërsa me dt.22.05.2024, e përpilon këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: F.D**, nga i ati N dhe e ëma Xh e lindjes K, i lindur më datën ..., në Rahovec me nr. personal:....., shqiptar, shtetas R së Kosovës, i martuar, i ati i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 29.12.2023, rreth orës 18:30 min, në Rahovec, në kufirin mes rrugëve të tyre, i pandehuri me dashje dëmton pasurinë e personit tjetër/këtu të dëmtuarit F.Sh dhe atë shtyllat e betonit, të vendosura nga i dëmtuari, në atë mënyrë që ditën kritike për shkak të pakënaqësisë së tij lidhur me vendosjen e shtyllave nga i pandehuri si vijë ndarëse mes rrugëve të tyre, i pandehuri pasi që kthehet në shtëpi, i thyen disa prej tyre dhe i rrëzon në tokë, me çka të dëmtuarit i shkakton dëm material

- Me këtë ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39,40, 46, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 321 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i'a shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej njëzet euro (20€), në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet euro (20€) ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

I dëmtuari F.Sh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.14/24 të dt. 17.01.2024, e ka akuzuar F.D, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 10.05.2024, ku prezent ishin Prokurorja e shtetit Uridia Caka, i akuzuari F.D si dhe i dëmtuari F.Sh, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari F.D, në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilin jam penduar, po ashtu kërkoj falje të dëmtuarit F.Sh, prandaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, të më shqiptohet një dënim sa më i butë, pasi që i kam kushtet e vështira ekonomike, jam i pa punë, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, po ashtu i premtoj gjykatës se ne të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos kryej kurrfarë vepre penale.

I dëmtuari F.Sh ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, i bashkangjitem ndjekjes penale dhe parashtroj kërkesë juridike për demin që është shkaktuar.

Prokurorja e Shtetit Uridia Caka ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari pranimin e fajësisë e bëri me vullnet të plotë, pa presion dhe pa shtytje nga askush, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

## 2. Vlerësimi i pranimet të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimet të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimet të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari F.D ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Raporti fillestar i incidentit dt.29.12.2023;
- Raporti i Oficerit M..K KPS #.... me nr. R-SH-Z-2022 i datës 29.12.2023;
- Deklarata e të pandehurit F.D, dhenë në polici me datë 29.12.2023;
- Deklarata e të dëmtuarit F.Sh, dhenë në polici me datë 29.12.2023;
- Foto dokumentacioni;
- Si dhe shkresat tjera në lëndë.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 321 par.1 të KPRK-së parashihet: Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

## 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin F.D, e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

## 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, kushtet e dobëta ekonomike, i pa punë, jeton me familjen 6 anëtarëshe, është mbajtës i familjes, me punë sezonale ne sektorin privat dhe atë kur gjenë punë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë veprë penale. Andaj duke mos gjetur rrethana rëndëse gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me dënimin me kusht në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve burgim**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## 7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

## 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449, par.1 dhe 2 të KPPK-së. ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39, parg.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.2024:018755, dt.13.05.2024.**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.